


Nr. 67 prot

Dt. 12/12/2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 2 Datë 11.12.2018

“ PËR MIRATIM E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI
ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “ECO ENERGY” SH.P.K.

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, nenit 42, nenit 51 dhe nenit 52, të ligjit nr. 6/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 111/2012 dt.15.11.2012 Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM nr.416 datë 13.05.2015 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”, të Miratimit Paraprak për vazhdimin e procedurave nga MEI nr. 4794/3 Prot., datë 29.05.2017, për paisjen me leje të përdorimit të burimit ujor, subjektit “ECO ENERGY” SH.P.K, me propozim të A.B.U Drin- Bunë, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin e lejes për përdorim të burimit ujor **Përroi i Sërriqës**, për prodhim energjie elektrike në fshatin Qam, Njësia Administrative Malzi, Bashkia Kukës, Qarku Kukës, subjektit “**ECO ENERGY**” **sh.p.k.** me administrator Z.Kravis MEÇI.

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti, **HEC QAM** do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes : X - 4661308.5; Y - 517311.05; Z - + 390 m;

Koordinatat e godinës së centralit: X - 4662419.74; Y - 518656.54; Z - + 349 m;

Koordinatat e pikes së shkarkimit : X - 4662419.74; Y - 518656.54; Z - + 349 m;

Prurja mesatare e përroit: Q mes = 1.54 m³/sek;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q llog = 2.5 m³/sek;

Prurja ekologjike: Q ekol = 0.1 m³/sek;

Prurja që shkarkohet: Q = 2.5 m³/sek.

2-Leja e përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak sipas akteve ligjore dhe nënligjore.



PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

